

Udhëzuesi për aplikim për grante për projekte në fushën tematike të integritit social të të rinjve

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në kuadër të Skemës për përkrahje të shoqërisë civile financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut (këtej e tutje referuar si Skema e Luksemburgut), do të përkrahë Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ) vendore¹ përmes granteve për projekte në fushën e integritit social të të rinjve. **Afati i fundit për aplikim është data 13 mars 2020.**

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj thirrje është të përkrahë nismat e shoqërisë civile në Kosovë, përmes mbështetjes financiare të projekteve të OJQ-ve, në njërën nga tri fushat e skemës së Luksemburgut², atë të integritit social të të rinjve.

Skema do të mbështesë OJQ-të të cilat paraqesin propozime të plota dhe bindëse që kontribuojnë në arritjen e rezultateve konkrete, përdorin roli i gruas, barazia gjinore dhe integritimi i minoriteteve duhet të mbështetet dhe promovohet sistematikisht në të gjitha aktivitetet.

Të arriturat përfundimtare të fushës tematike të përkrahura nga kjo skemë pritet të kontribuojnë në arritjen e këtyre rezultateve:

1. Rritje e përfshirjes dhe kontributit të OJQ-ve në objektivat e thirrjes të prezantuara më poshtë;
2. Fuqizimi i bashkëpunimit mes shoqërisë civile, qytetarëve dhe institucioneve publike;
3. Fuqizimi i rolit të vajzave dhe grave përmes përfshirjes në nisma me bazë në komunitet dhe procese politikë-bërëse.

I. Integritimi social i të rinjve

Situata aktuale socio-ekonomike në Kosovë paraqet sfida për integrimin e plotë të rinisë në shoqëri. Vendi ka shumë të rinj në kushte jo të mira që nuk janë të angazhuar në aktivitete sociale: pothuajse 43% e popullsisë është nën moshën 25 vjeçare; shkalla e papunësisë është të paktën 30% dhe rreth 55% në mesin e të rinjve, përdorin shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës është më pak se

¹ Sipas definicionit në Ligjin për lirinë e asociimit në Organizatat Jo-qeveritare.

² Për më shumë rreth skemës shihni [linkun](#).

38%. Shumë studime të bëra nga organizata të ndryshme rreth kushteve të vështira socio-ekonomike në Kosovë tregojnë se varfëria, papunësia dhe nivelet e ulëta të arsimit paraqesin rrezik për përjashtim social të të rinjve. Gjithashtu, sipas tyre, mungesa e angazhimit social, papunësia dhe mungesa e arsimit cilësor të të rinjve, rezulton me aftësi të dobëta të të menduarit kritik që është i nevojshëm për të dalluar informacionin e vërtetë / faktik nga ai jo i vërtetë dhe propagandues, parametra këta që krijojnë lehtësi për indoktrinimin e të rinjve kosovarë.

ii. Qëllimi i përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj fushe tematike është përkrahja e integritit social të të rinjve, përmes arritjes së dy objektivave në vijim, në kuadër të fushave prioritare të paraqitura më poshtë:

Objektiva 1: Angazhimi aktiv i rinisë për qytetari aktive dhe përfshirje sociale është rritur

Fushat prioritare:

1.1 Rinia është e informuar dhe e përfshirë në procese vendim-marrëse

1.2 Rinia përfshihet në nisma vullnetare për kauza sociale

1.3 Rinia përfshihet në aktiviteteve jashtë-kurrikulare

Objektiva 2: Të rinjtë kanë më shumë mundësi për angazhim në tregun e punës

Fushat prioritare:

2.1 Rinia është e pajisur me aftësi kyçe të transferueshme

2.2 Rinia ka mundësi për të krijuar përvojë pune

2.3 Rinia përfiton nga mundësitë e vet-punësimit

Organizatrat mund të aplikojnë vetëm në njërin nga dy objektivat, me mundësi kombinimi ndërmjet tri fushave prioritare brenda të njëjtës objektivë. Në rast se në formë indirekte projekti juaj kontribuon në ndonjërin nga fushat prioritare të objektivës tjetër kjo nuk paraqet problem, përderisa shumica e projektit i dedikohet njëres objektivë për të cilën deklaroheni.

iii. Fushat prioritare për intervenim:

O 1: Angazhimi aktiv i rinisë për qytetari aktive dhe përfshirje sociale është rritur.

1.1. Rinia është e informuar dhe e përfshirë në procese vendim-marrëse. Kjo fushë prioritare ka për qëllim të adresojë mungesën e përfshirjes cilësore, aktive, dhe të vazhdueshme të të rinjve në jetën sociale. Si e tillë, ajo përqendrohet në ndryshimet që do të krijojnë mundësi dhe hapësirë për angazhim, qytetari aktive, si dhe për përpjekje të suksesshme të avokimit nga të rinjtë, për komunitetin e tyre dhe shoqërinë në përgjithësi, mbi çështje relevante për këtë grupmoshë. Çështjet e të rinjve duhet të përkohet me komunitetin për të cilin avokohet nga vet të rinjtë, duke nxitur vendime relevante me kontekstin dhe kohën. Është e rëndësishme që zëri rinor të jetë i përfaqësuar në proceset vendimmarrëse në nivel lokal.

Prandaj, kjo fushë prioritare synon të rrisë pjesëmarrjen efektive të të rinjve, organizatave rinore dhe organizatave të tjera, në proceset vendimmarrëse që ndikojnë në jetën e tyre sociale, ekonomike dhe kulturore në komunitetet ku ata jetojnë. Rezultatet e këtij aktiviteti do të vlerësohen me numrin e të rinjve të angazhuar dhe të përfshirë në procese vendimmarrëse në nivel lokal.

1.2. Rinia përfshihet në nisma vullnetare për kauza sociale. Aktivitetet në këtë fushë prioritare duhet të nxisin interesim, motivim dhe angazhim të të rinjve në kërkim dhe prodhim të ndryshimeve konkrete sociale dhe kulturore përmes vullnetarizmit. Zhvillimi social i të rinjve si dhe zhvillimi i kreativitetit të tyre është dëshmuar të jetë i suksesshëm kur rinia është e lirë për t'u angazhuar në tema që u përkasin atyre. Andaj, në kuadër të kësaj fushe prioritare, KCSF do të përkrahë intervenimet që kanë për qëllim krijimin e hapësirave për angazhim të të rinjve në çështje sociale apo aktivitete kulturore përmes vullnetarizmit. Intervenimet duhet të ofrojnë mundësi angazhimi vullnetar bashkë me ofrimin e mundësive për mësim. Vullnetarizmi, sporti, kultura dhe aktivitetet rekreative janë instrumente me shumë vlerë për integrimin e të rinjve në aspektin social. Rrjedhimisht, kjo fushë prioritare ka për qëllim të nxisë vullnetarizmin për kauza sociale të grupeve të ndjeshme dhe do të vlerësohet me nivelin e pjesëmarrjes së të rinjve në këto aktivitete.

1.3. Rinia përfshihet në aktiviteteve jashtë-kurrikulare. Në gjendjen aktuale politike, ekonomike dhe sociale të Kosovës ka shumë nevojë për të rinjë më të zëshëm dhe të angazhuar aktivisht në çdo aspekt të jetës sociale. Për të realizuar këtë, të rinjtë duhet të kenë aftësi që do të ju mundësonin të ushtrojnë ndikim në ambientin e tyre. Kjo fushë prioritare do të përfshijë angazhim social jashtë-kurrikular me qëllim të nxitjes së mendimit kritik të të rinjtë dhe do të vlerësohet me numrin e të rinjve pjesëmarrës. Për të arritur më shumë rezultate, skema do të përkrahë intervenimet në nivel lokal, ndërsa angazhimi i të rinjve që jetojnë në qyteza dhe fshatra do të ketë fokus të veçantë. Intervenimet me bazë shkollore paraqesin një tjetër mundësi të përkrahjes ashtu që të ju mundësojnë gjeneratave të reja pjesëmarrje në aktivitete.

O 2: Të rinjtë kanë më shumë mundësi për angazhim në tregun e punës.

2.1. Rinia është e pajisur me aftësi kyçe të transferueshme. Kjo fushë prioritare përqëndrohet në ofrimin e aftësive dhe njohurive mbi teknologjinë informative dhe gjuhët e huaja, të rëndësishme dhe të aplikueshme në të gjithë sektorët dhe llojet e angazhimeve. Sektori i teknologjisë informative dhe kontraktimit të proceseve të punës në industrinë e shërbimeve, ka përjetuar rritje viteve të fundit në Kosovë. Ky sektor ka shumë nevojë për personel të kualifikuar përderisa sistemi i edukimit nuk arrin të ofrojë kuadër të tillë. Në kuadër të këtij sektori ka profesione që kërkojnë aftësi të caktuara për të cilat ka shumë kërkesë. Prandaj, përmes këtij intervenimi parashikohet aftësimi i të rinjve me shkathtësi të transferueshme të cilat mund të zotërohen përmes kurseve apo trajnimeve afatshkurta e që mund të rezultojnë me gjasa më të mëdha për punësim afatgjatë.

Për më tepër, këtu mund të hyjnë edhe intervenimet për trajnime të ndryshme në përgatitje për tregun e punës (hartimi i CV-së, letër motivimit, përgaditja për intervistë, etj.) dhe trajnimet në ndërmarrësi sociale – të cilat gjithashtu hyjnë në kategorinë e përvetësimit të aftësive të buta³.

2.2. Rinia ka mundësi për të krijuar përvojë pune. Duke pasur parasysh se aftësitë profesionale specifike janë mbuluar relativisht mjaftueshëm përmes programeve të zbatuara dhe financuara nga donatorë të tjerë, ndërhyrjet në këtë fushë prioritare do të përqendrohen në të mësuarit eksperimental, përmes praktikave të cilat mbështesin të rinjtë për të fituar përvojë të zbatueshme në çdo profesion që ata/ato mund të praktikojnë. Pavarësisht nëse të rinjtë kanë arsim të mesëm profesional apo tradicional, ky angazhim do t'u sigurojë atyre aftësi themelore dhe të transferueshme të tregut të punës, dhe aftësi që do të mund të ndikojnë në shkurtimin e periudhës së kalimit nga shkolla në tregun e punës ose arsimimin e mëtejshëm të specializuar.

2.3. Rinia përfiton nga mundësitë e vet-punësimit. Kjo fushë prioritare do të fokusohet kryesisht në sigurimin e mbështetjes së vet-punësimit të të rinjve në sektorë të ndryshëm ekonomikë. Nisma të tilla do të mbështeten përmes aftësimit dhe ofrimit të lëndëve të para siç janë materialet e punës apo/dhe mjetet e punës. Përveç kësaj, kjo fushë prioritare do të mbështesë edhe qendrat e punës⁴ të cilat ju ofrojnë të rinjve hapësira të punës ku idetë e reja mund të marrin formë dhe të shëndrrohen në biznese fitimprurëse.

Së fundmi, kjo fushë prioritare do të mbështesë edhe mundësitë e vet-punësimit për të rinjtë e angazhuar në bujqësi ose që njohin zanate të caktuara. Megjithëse ka të rinjë me aftësi në këto fusha, atyre u mungon qasja në treg, burimet e mjaftueshme për të mbajtur bizneset e tilla ose për t'i rritur ato. Meqenëse Kosova vazhdimisht po bëhet destinacion turistik, zejtaria dhe artizanatet mund të jenë një nga sektorët potencial për t'u mbështetur. Kjo do të ndihmonte në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të caktuara të kulturës në Kosovë që mund të jenë atraksion për turizmin rural.

iv. Të arriturat kryesore

Aplikacionet duhet të specifikojnë të arriturat kryesore të synuara⁵ të cilat duhet të jenë të arritshme dhe të matshme dhe t'i shërbejnë përbushjes së objektivës për të cilën aplikoni. Gjithashtu, logjika e intervenimit dhe aktivitetet duhet të jenë të ndërlidhura qartë me të arriturat kryesore brenda afatit të propozuar.

v. Përfituesit e synuar

Aplikacionet duhet të synojnë të rinjtë e moshës 15-29 vjeçare. Shpërndarja gjinore duhet të jetë e barabartë, me mundësi përjashtimi vetëm në raste të veçanta dhe me shpjegim të qartë të nevojës për

³ Në anglisht: *soft skills*

⁴ Në anglisht: *makerspaces*

⁵ Në anglisht: *project milestones*

përrjashtim. Kurdo që është e mundshme, qasje e njëjtë duhet të aplikohet edhe për përfshirjen e pakicave.

Të rinjtë përfitues duhet të plotësojnë të paktën një nga kriteret në vijim: a) të jenë të papunë, b) të kenë nivel të ulët të arsimit apo trajnimit, c) t'u përkasin familjeve që jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe sociale, d) të jenë joaktiv në tregun e punës, ose e) të kenë përvojë pune të kufizuar.

vi. Intervenimet/aktivitetet e papranueshme

Intervenimet e mëposhtme nuk do të përkrahen përmes kësaj skeme:

- Aktivitete të njëjta ose shumë të ngjashme në atë lokacion e të përkrahura nga KCSF përmes projekteve tjera nga kjo skemë (për të parë projektet e financuara nga kjo skemë, ju lutem vizitoni <https://www.kcsfoundation.org/grantet/grantet-e-perkrahura/grantet-e-luksemburgut/>);
- Projekte që kryesisht përmbajnë aktivitete përgatitore apo hulumtime/studime;
- Aktivitete të natyrës së ofrimit të shërbimeve që më shumë i takojnë asistencës teknike;
- Aktivitete të vetme e të shkurta (p.sh. Një panair, një konferencë, një koncert, etj.)⁶;
- Fushata të ngritjes së vetëdijes pa aktivitete përcjellëse;
- Aktivitete që kanë varshmëri nga shumë nivele të vendimmarrjes, prandaj paraqesin rrezikshmëri të lartë për arritjen e rezultateve;
- Nën grantimi i palëve të treta. Përkrahja e vogël financiare për përfituesit lejohet vetëm nëse të gjitha shpenzimet ekzekutohen nga organizata zbatuese;
- Intervenimet me ndërlidhje të drejtpërdrejt apo në përkrahje të partive politike;
- Ndihmat emergjente apo bamirësia;
- Investimet kapitale;
- Bursat për shkollim jashtë vendit.

Në parim, skema nuk do të përkrahë aktivitetet e paraqitura më poshtë, përveç rasteve kur ato janë të domosdoshme për arritjen e rezultateve të synuara:

- Organizimin e konferencave apo tryezave;
- Realizimin e hulumtimeve dhe studimeve të fizibilitetit, veçanërisht para fillimit të aktiviteteve të parapara;
- Vizitat studimore jashtë Kosovës.

vii. Shpenzimet e pranueshme

⁶ Anglisht, one shot events

Për të qenë të pranueshme, shpenzimet duhet të përmbushin kriteret në vijim:

- Të jenë të domosdoshme për zbatimin e suksesshëm të projektit dhe arritjen e rezultateve të specifikuara të projektit;
- Të jenë të arsyeshme, të justifikuar dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit efektiv financiar, përfshirë kalkulimet e drejta dhe të bazuara në treg si dhe kosto-efikase;
- Të jenë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm tatimor;
- Të ndodhin gjatë zbatimit të projektit;
- Të jenë të specifikuar në buxhetin e propozuar;
- Të jenë të identifikueshme dhe të verifikueshme.

viii. Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e paraqitura më poshtë konsiderohen si të papranueshme:

- Tatimi mbi vlerën e shtuar TVSH (kjo vlenë për të gjitha faturat mbi 200 EUR);
- Dogana dhe pagesat e importit;
- Borxhet apo pagesat për humbjet;
- Pagesa e kredisë apo interesit (kamata);
- Shpenzimet e këmbimit valutor;
- Shpenzimet e zhvlerësimit të pajisjeve;
- Blerjet e tokës apo e pasurisë së paluajtshme;
- Blerjet e veturës apo gjeneratorit;
- Pagesat e shpenzimeve të mbuluara nga donatorë tjerë.

iv. Kriteret për aplikim

Për të pasur të drejtë aplikimi, aplikuesi duhet të përmbushë kushtet si në vijim:

- Të jetë organizatë joqeveritare vendore e regjistruar sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë,
- Të jetë drejtpërdrejtë përgjegjëse për menaxhimin e projektit dhe të mos ketë rol ndërmjetësues,
- Të ketë qarkullim vjetor jo më shumë se 25,000 EUR në vit (në secilin nga tre vitet e fundit: 2017-2018-2019) si dhe të jetë organizatë me bazë në komunitet⁷
- Të tregojë kapacitet për menaxhimin e aktiviteteve të propozuara.

x. Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikant

⁷ Organizatë e vogël me bazë në komunitet

Organizatat aplikuese mund të aplikojnë vetëm me një aplikacion.

xi. Kohëzgjatja dhe buxheti

Kohëzgjatja maksimale për grant është **6 muaj** ndërsa buxheti maksimal është **10,000 EUR (përfshirë shpenzimet e auditimit të projektit)**. Kohëzgjatja e aktiviteteve duhet të arsyetohet ndërsa buxheti duhet të jetë real dhe të sigurojë zbatim cilësor të aktiviteteve.

Procedura e aplikimit

xii. Dokumentet për aplikim dhe mënyra e aplikimit

Aplikantët duhet të plotësojnë aplikacionin, planin e aktiviteteve dhe buxhetin sipas formularëve përkatës. Aplikacionet e kompletuara duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike në formatin word në kcsfluxaplikimi@kcsfoundation.org. Bashkë me dokumentet e lartpërmendura aplikantët duhet të dërgojnë edhe certifikatën e regjistrimit të OJQ-së lëshuar nga Departamenti për OJQ. dhe certifikatën e numrit fiskal.

Lista e dokumenteve të domosdoshme:

1. Certifikata e regjistrimit si OJQ, lëshuar nga Departamenti për OJQ.
2. Certifikata e numrit fiskal (këto dy të parat të dorëzohen në formë të skenuar), lëshuar nga ATK
3. Forma e aplikimit
4. Buxheti
5. Plani i aktiviteteve

Dokumentet tjera shtesë, vetëm në raste të veçanta, sikur:

Në rast të bashkëfinancimit për këtë projekt, bashkëngjitni dëshminë e bashkëfinancimit (p.sh. kontratën, vendimin, letër zotimin etj.);

Nëse aktivitetet e projektit janë të varura nga bashkëpunimi me ndonjë institucion publik (Kuvend, ministri, gjykatë, prokurori, komunë, agjenci e pavarur, ndërmarrje publike etj.), bashkëngjitni dokumentin që dëshmon këtë bashkëpunim (Memorandum bashkëpunimi, Letër e përkrahjes, Letër e zotimit, etj.).

Kur parashikohet partneritet me OJQ tjera, bashkëngjitni certifikatat e regjistrimit të partnerëve të propozuar.

xiii. Afati për aplikim

Afati për aplikim është **13 mars 2020**. Aplikacionet e dorëzuara pas orës 23:59 të datës 13 mars 2020 nuk do të shqyrtohen.

xiv. Vlerësimi

Vlerësimi do të bëhet në dy faza: 1) Vlerësimi i kontrollit administrativ (verifikimi i kritereve formale) dhe 2) vlerësimi i plotë.

xv. Kontrolli administrativ (verifikimi i kritereve të caktuara)

Gjatë kësaj periudhe të gjitha aplikacionet vlerësohen nëse kanë respektuar/përmbushur kriteret në vijim:

1. Afati për dorëzimin e projekteve;
2. Numri i aplikacioneve të dorëzuara nga aplikanti;
3. Kërkesat teknike të specikuara në formën e aplikimit;
4. Shtojcat/dokumentet obligative;
5. Qarkullimi vjetor i OJQ-së për 3 vitet e fundit nuk kalon shumë më 25,000 EUR (e ndarë për vit);
6. Lartësia e buxhetit;
7. Kohëzgjatja e projektit.

Aplikacionet që nuk i përmbushin rregullat e specifikuar më lartë do të refuzohen automatikisht.

Rezultatet e kontrollit administrativ do të ju komunikohen secilit aplikant përmes emailit.

xv. Kriteret për vlerësim

Aplikacionet të cilat kalojnë kontrollin administrativ do të vlerësohen në përputhje me kriteret e paraqitura më poshtë. Vlerësimi do të kryhet nga Bordi i jashtëm i pavarur i vlerësimit, i përbërë nga anëtarë me përvojë me programe të ngjashme dhe njohuri në fushat dhe zhvillimet përkatëse.

xvi. Vlerësimi i plotë i aplikacioneve

I. Kapacitetet e organizatës dhe përvoja relevante (20%)

- i. Kapacitetet organizative dhe teknike - personeli, (keni parasysh se përfshirja e vajzave dhe grave do të vlerësohet me më shumë pikë), infrastruktura e përshtatshme për zbatimin e intervenimit të propozuar, kapaciteti për menaxhim financiar);*
- ii. Relevanca e përvojës paraprake (3 projektet relevante).*

II. Elaborimi i problemit dhe përshkrimi i projektit (60%)

Ndërlidhja e idesë me objektivin dhe fushën(at) prioritare të përzgjedhur(a) do të jetë kushti kryesor për shqyrtim të aplikacionit. Kjo nënkupton që vetëm aplikacionet të cilat e plotësojnë këtë kusht do t'i nënshtrohen vlerësimit të cilësisë sipas kritereve të paraqitura më poshtë.

- i. *Përshkrimi dhe elaborimi i problemit;*
- ii. *Propozimi për adresimin/zgjidhjen e problemit;*
- iii. *Qasja dhe plani i zbatimit (aktivitetet);*
- iv. *Qasja në komunitet dhe angazhimi i tyre;*
- v. *Të arriturat kryesore duke specifikuar rezultatet konkrete dhe të matshme që synohen të arrihen përmes këtij intervenimi;*
- vi. *Përshkrimi dhe shpjegimi i aktiviteteve, përfshirë masat e propozuara për të siguruar mbështetje dhe promovim sistematik të rolit të vajzave/grave, barazisë gjinore dhe integritit të minoriteteve;*
- vii. *Informata mbi përfituesit e synuar me fokus te grupet e ndjeshme, përfshirë ndarjen në bazë të moshës, gjinisë dhe rajonit;*
- viii. *Identifikimi i palëve të përfshira dhe shpjegimin e rolit të tyre në zbatim;*
- ix. *Mundësinë për përsëritje dhe/ose zgjerim të aktiviteteve;*
- x. *Rreziqet potenciale që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e këtij projekti.*

III. Buxheti (20%)

- i. *Efektiviteti i buxhetit të propozuar.*

Maksimumi i pikëve të arritshme është 100 pikë, ndërsa pragu minimal i kalueshmërisë është 70 pikë.

xvii. Vendimi final

Do të mbështeten aplikacionet me më së shumti pikë në kuadër të buxhetit në dispozicion për këtë thirrje. Ambasada e Luksemburgut në Prishtinë do të konsultohet para vendimit final. Ambasada ka të drejtë të refuzojë projekt propozimet.

Para se të kontraktohen, aplikantët e suksesshëm do të përfitojnë nga përkrahja e KCSF-së nëpërmjet sesionieve këshilluese për finalizimin e projekt-propozimeve të tyre.

Datat me rëndësi

Procesi	Datat tentative
Lansimi i thirrjes	14 shkurt 2020

Sesionet informuese Pejë Mitrovicë e Jugut Mitrovicë e Veriut Prizren Prishtinë	Sesionet informuese në komuna do të mbahen nga data 20 shkurt – 02 mars 2020. Për kohën dhe vendin e saktë të sesioneve informuese ju lutem vizitoni ueb faqen www.kcsfoundation.org .
Afati për pyetje/sqarime rreth aplikimit	28 shkurt
Data e fundit e publikimit të përgjigjeve	6 mars
Afati për dorëzimin e aplikacioneve	13 mars
Informimi i aplikantëve mbi rezultatet e kontrollit administrativ	19 mars
Informimi për vlerësimin nga Bordi	13 prill
Nënshkrimi i kontratave	Prill, 2020
Fillimi i zbatimit të projekteve	1 maj, 2020

xviii. Njoftimi mbi vendimin:

Secili aplikant do të njoftohet me vlerësimin e përgjithshëm/pikët totale përmes emailit.

Aplikantët e pasuksesshëm që vlerësojnë se mund të jenë dëmtuar nga ndonjë gabim ose padrejtësi gjatë procesit të vlerësimit mund të dërgojnë kërkesë për sqarim brenda 3 ditë pune pas ditës së pranimit të emailit të refuzimit të aplikacionit.

Në këto raste, KCSF do të informojë aplikantin/ët për pikët e pranuar në tri kategoritë kryesore (kapacitetet e organizatës dhe përvoja relevante, elaborimi i problemit dhe përshkrimi i projektit dhe buxheti). Në raste të veçanta nëse ka nevojë mund të organizohet edhe takim me aplikantin. Lista e përfituesve të granteve do të publikohet në www.kcsfoundation.org

xix. Kontakti

Për pyetje eventuale rreth përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për aplikim mund të na kontaktoni në kcsflux@kcsfoundation.org jo më larg se data 28 shkurt 2020. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet do të publikohen në webfaqe të KCSF-së me datë 6 mars 2020.

Për të pasur trajtim të barabartë dhe transparencë të plotë, KCSF nuk mund të jap mendim paraprak nëse aplikanti ka të drejtë aplikimi apo nëse aktiviteti mund të jetë i pranueshëm.

Ju lusim që të shmangët kontaktimi i KCSF-së në forma të tjera përpos emaileve të paraqitur me lartë.